



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:247497

Datë: 24.02.2024

Numri i dokumentit: 05369124

**P.nr.1263/2022**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Ardijana Reshtni, procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarit E. G., nga fshati Atmagjë Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale Ngacmimit nga neni 182 par.1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës 06/L-074 (KPRK). sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.2229-11/22 të datës 05.12.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren, Musli G., të akuzuarit, mbrojtësit të tij, avokat Muhamet Shalaj, si dhe të dëmtuarës - të miturës E. F., dhe përfaqëuseit të saj prindit - nënës K:M., , me datë 13.12.2022, morri dhe publikisht shpalli

**A K T G J Y K I M**

**E. G.**, nga i ati ....., e ëma ....., e lindur ....., i lindur më .....në Prizren, me banim në fshatin Atmaxhë, Komuna e Prizrenit, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal . .....

**Ë S H T Ë F A J T O R**

Se nga data e pavërtetuar e në vazhdimësi deri më 22.11.2022 në rr. “.....” në Prizren, i pandehuri E. G., përfshihet në një sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të padëshirueshme, i cili duke e përcjellë të dëmtuarën E.F e cila është viktimë e ndjeshme për shkak të moshës së mitur, e vë të njëjtën nën vëzhgim me qëllim të ngacmimit dhe frikësimit të saj, në atë mënyrë derisa e dëmtuara e lartpërmendur e kishte përfunduar mësimin dhe kishte dal nga shkolla për të shkuar në shtëpinë e saj, e cila gjersa ishte duke ecur në këmbë përgjatë rrugës së lartpërmendur, për një çast përpara i del i pandehuri duke iu drejtuar të dëmtuarës me fjalët “ *ku je moj ti, hajde veç pak të flasim* “ e cila i kishte thënë “ largohu se po e thërras policinë”, ku i pandehuri më pas i drejtohet me fjalë “*mos gabon sen me bo*” dhe e dëmtuara nga frika dhe shqetësimi menjëherë është larguar nga vendi e cila ndalet tek një tregtar nga i cili kërkon telefonin për të kontaktuar nënën e saj e cila pas kontaktimit, vazhdon rrugën për në shtëpi, ku i pandehuri ka vazhduar duke përcjellë lëvizjen e të dëmtuarës, e cila pasi e vëren se i pandehuri është duke e përcjellë, nga frika se do ti ndodhë ndonjë gjë e keqe, hynë në një

lokal duke i thënë punëtorit se “ *i pandehuri është duke e përndjekur*”, ku i pandehuri hynë në këtë lokal duke i thënë punëtorit “ *që të nxjerrë jashtë të dëmtuarën, se dëshiron të flas*”, e cila qëndron në këtë lokal derisa ka ardhur nëna e saj, ndërsa i pandehuri është larguar nga vendi i ngjarjes, si rrjedhojë e këtyre veprimeve tek e dëmtuara e lartpërmendur shkakton shqetësim, frikë dhe pasiguri të madhe për jetën e saj personale.

**Me këto veprime ka kryer veprën penale: Ngacmimi nga neni 182 par.1 i Kodit nr.06/L-074 Penal të Kosovës.**

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 7, 38, 39 par.1 pika 1.1 40 par. 1 pika 1.3, 43, 69, 70, 71 72 dhe 182 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr.06/L-074 te akuzuarit i shqipton:

**DENIM ME GJOBË**

Dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqinde) Euro, në të cilën shumë të dënimit të shqiptuar me gjobë do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 22.11.2022 deri me datën 13.12.2022, duke i llogaritur si zëvendësim për 1 (një) ditë të kalimit në paraburgim nga 20,00 Euro, në shumë të përgjithshme prej 400 (katërqind) Euro, andaj i akuzuari obligohet të paguaj shumën e mbetur të dënimit me gjobë të shqiptuar prej 100 (njëqind) Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmëris të aktgjykimit, në rast se i njëjti nuk mund të paguaj apo dënimi i mbetur i shqiptuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim duke i llogaritur si zëvendësim për çdo 20,00 Euro 1 (një) respektivisht 5 (pesë) ditë burg,

Obligohet i akuzuari qe të paguaj shpenzimet në emër të paushallit gjyqësore shumen prej 20,00, Euro, si dhe n; emër të mbrojtjes së viktimave shum[n prej 30,00 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

E dëmtuara E. (I) F., nga Prizreni, rr.”.....” për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.2229-11/22 të datës 05.12.2022, kundër të akuzuarit E. G., nga fshati Atmagjë Komuna e Prizrenit, me numër personal 1248143106, për shkak të veprës penale Ngacmimit nga neni 182 par.1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës 06/L-074 (KPRK).

Prokurori i shtetit Musli G., në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: mbetem në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.2229-11/22 të datës 05.12.2022, të parashtruar kundër të akuzuarit E. G., nga fshati Atmaxhë Komuna e Prizrenit, me numër personal 1248143106, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale të Ngacmimit nga neni 182 par.1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës 04/L-082 (KPRK), pasi që gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës është vërtetuar në mënyrë të qartë dhe të plotë me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili paraprkishtë ishte i njoftuar me të gjitha pasojat e pranimin të fajësisë, dhe se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare konform nenit 248 të KPP-ës, i propozoj

gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, të ketë parasysh këtë rrethanë si rrethanë lehtësuese.

Përfaqësuesja ligjore e të dëmtuarës E. F., - nëna saj K.M., në fjalën e saj përfundimtare deklaron që si palë e dëmtuar nuk parashtron kërkesë pronësoro juridike, por kërkon që i akuzuari të përmbahet nga veprimet e tilla, të mos përsërit veprën penale të kësaj natyre ndaj bijës së saj, si dhe që të njëjtën ta le të qetë në jetën e saj në të ardhmen.

Mbrojtësi i të akuzuarit E. G., avokat M.Sh., , në fjalën e tij përfundimtare deklaron: pas konsultimit me të mbrojturin tim i njëjti e ka pranuar veprën penale për të cilën akuzohet, konsideroj se pranimi fajësisë është bërë konform kodit penal dhe dua të shtoj se i mbrojturi im i ka kuptuar pasojat e kësaj vepre penale dhe njëherit deklaron se në të ardhmen nuk do të përsëris veprimet e tilla andaj kërkoj nga gjykata që të njëjtit ti shqiptoj një dënim që nuk do të ndikoj në zhvillimin e tij psikofizik, ashtu që duke marrë për bazë se i njëjti pranë kësaj gjykate i kërkon falje dhe familjes së të dëmtuarës, gjykata të njëjtit ti shqiptoj një dënim sa më të butë, gjithashtu i propozoj gjykatës që duke pasur parasysh se i mbrojturi im pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barë, si dhe pasi që i njëjti është nën masën e paraburgimit, konsideroj se kanë pushuar të gjitha kushtet për çka është caktuar paraprakisht i njëjti, andaj nga të cekurat që ndaj të njëjtit me ditën e sotme ti ndërpritet masa e paraburgimit.

I akuzuari E. G., në fjalën e tij përfundimtare deklaron: se përkrah fjalën e mbrojtësit të tij dhe shton se pendohet thellë për veprën e kryer i premtion gjykatës që në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe të përmbahet nga veprimet e tilla si dhe sot para gjykatës deklaron përfundimisht premtimin se më nuk do të përsëris vepra të tilla apo të ngjashme.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike;

Se nga data e pavërtetuar e në vazhdimësi deri më 22.11.2022 në rr. “Wiliam Walker” në Prizren, i pandehuri E. G., përfshihet në një sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të padëshirueshme, i cili duke e përcjellë të dëmtuarën E.F e cila është viktimë e ndjeshme për shkak të moshës së mitur, e vë të njëjtën nën vëzhgim me qëllim të ngacmimit dhe frikësimit të saj, në atë mënyrë derisa e dëmtuara e lartpërmendur e kishte përfunduar mësimin dhe kishte dal nga shkolla për të shkuar në shtëpinë e saj, e cila gjersa ishte duke ecur në këmbë përgjatë rrugës së lartpërmendur, për një çast përpara i del i pandehuri duke iu drejtuar të dëmtuarës me fjalët “ *ku je moj ti, hajde veç pak të flasim* “ e cila i kishte thënë “ largohu se po e thërras policinë”, ku i pandehuri më pas i drejtohet me fjalë “ *mos gabon sen me bo*” dhe e dëmtuara nga frika dhe shqetësimi menjëherë është larguar nga vendi e cila ndalet tek një tregtar nga i cili kërkon telefonin për të kontaktuar nënën e saj e cila pas kontaktimit, vazhdon rrugën për në shtëpi, ku i pandehuri ka vazhduar duke përcjellë lëvizjen e të dëmtuarës, e cila pasi e vëren se i pandehuri është duke e përcjellë, nga frika se do ti ndodhë ndonjë gjë e keqe, hynë në një lokal duke i thënë punëtorit se “ *i pandehuri është duke e përndjekur*”, ku i pandehuri hynë në këtë lokal duke i thënë punëtorit “ *që të nxjerrë jashtë të dëmtuarën, se dëshiron të flas*”, e cila qëndron në këtë lokal derisa ka ardhur nëna e saj, ndërsa i pandehuri është larguar nga vendi i

ngjarjes, si rrjedhojë e këtyre veprimeve tek e dëmtuara e lartpërmendur shkakton shqetësim, frikë dhe pasiguri të madhe për jetën e saj personale.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili në shqyrtimin gjyqësor vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak të cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me neni 248 të KPP-ës dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale Ngacmimi nga neni 182 par.1 i Kodit nr.06/L-074 Penal të Kosovës.

Me rastin e marrjes së vendimit të dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KPRK-ës të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte e tij pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, konform nenit 70 të KPRK gjykata mori si rrethanë lehtësuese rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, moshën e të njëjtit, pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga ana e personit të dënuar, është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, më herët nuk ka qenë i dënuar, çka do të thotë se nuk ka ra ndeshë me rregullat pozitive, moshë e të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale, sjellja e tij pas konfliktit, kërkim falja publike para gjykatës ndaj të dëmtuarit, andaj gjykata i shqiptoi dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqinde) Euro, në të cilën shumë të dënimit të shqiptuar me gjobë do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 22.11.2022 deri me datën 13.12.2022, duke i llogaritur si zëvendësim për 1 (një) ditë të kalimit në paraburgim nga 20,00 Euro, në shumë të përgjithshme prej 400 (katërqind) Euro, andaj i akuzuari obligohet të paguaj shumën e mbetur të dënimit me gjobë të shqiptuar prej 100 (njëqind) Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmëris të aktgjykimit, në rast se i njëjti nuk mund të paguaj apo dënim i mbetur i shqiptuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim duke i llogaritur si zëvendësim për çdo 20,00 Euro 1 (një) respektivisht 5 (pesë) ditë burg, sepse konsideron se me këtë lartësi dhe lloj të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, duke menduar se dënim i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jenë më i kujdesshëm dhe do të përmbahen nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi kërkesën pronësoro juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPPK-ës.

Vendimin mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPPK -së.

Vendimin mbi kompensimin e viktimave të krimit gjykata e bazoi në kuptim ligjit nr.08/L-109

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.1263/2022 me datë 13.12.2022**

**Procesmbajtësja**  
**Ardijana Reshtani,**

**Gjyqtari**  
**Luan Berisha**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.